



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 9.9.2014, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin në lidhje me një amendament të konventës së aviacionit civil ndërkombëtar (neni 3 bis), të nënshkruar në Montreal në datën 10 maj 1984”.

2. Shqyrtimi i projektligjit “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Armando Subashi, Piro Lutaj, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku, Tom Doshi dhe Silva Caka

Mungojnë:

Dashamir Peza, Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Kastriot Islami, Tahir Muhedini, Fatmir Mediu, Eduard Halimi dhe Mhill Fufi.

Të ftuar:

Krislen Keri – shef kabineti i Ministrisë së Transporteve dhe këshilltar për aviacionin civil.

Renata Teta – specialiste në Sektorin e Politikave të Transportit Ajror.

Sajmir Tahiri – ministër i Brendshëm.

Pranvera Behushi – drejtoreshë Juridike në Ministrinë e Brendshme.

Alma Mele – përfaqësuese e Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët.

Renata Palluci – specialiste e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Brendshme.

HAPET MBLEDHJA

Fatmir Xhafaj – Mirëmëngjesi!

Sot në rendin e ditës kemi projektligjin “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin në lidhje me një amendament të konventës së aviacionit civil ndërkombëtar (neni 3 bis), të nënshkruar në Montreal në datën 10 maj 1984”.

Nga Ministria e Transporteve janë prezentë zoti Keri, shefi i kabinetit të Ministrisë së Transporteve dhe këshilltar i ministrit për aviacionin civil, dhe zonja Teta, specialiste e Sektorit të Politikave të Transportit Ajror.

Fillimisht do të dëgjojmë zotin Keri. Ju lutem, na bëni një përmbledhje të shkurtër, sepse është e njohur, për shkak se të gjithë e kanë në tavolinë, pastaj do të dëgjojmë relatorin.

Krislen Keri – Faleminderit, zoti kryetar!

Propozimi për këtë projektligj vjen si pasojë e amendimit të konventës së aviacionit civil ndërkombëtar, e nënshkruar në Montreal në datën 10 maj 1984, e cila ka hyrë në fuqi më 1 tetor 1998. Ky amendim ka të bëjë me ekzaktësisht me ndalimin e interceptimit të aviacionit civil gjatë fluturimit për të garantuar parrezikshmëri për pasagjerët.

Propozimi për aderimin e Republikës së Shqipërisë në këtë konventë ndoshta ka ardhur disi me vonesë, por, duke qenë se ka disa limite në transpozimin e të gjithë legjislacionit ndërkombëtar të aviacionit civil, kjo është në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ndërkombëtare dhe u paraprin disa ndryshimeve të tjera, që faktikisht kanë qenë gjetje të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil.

Jam i hapur për çdo pyetje më specifike.

Fatmir Xhafaj – Faleminderit!

Edhe relatori ka paraqitur relacionin, ku në përfundim të tij ka parashtruar faktin që marrëveshja është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin kuadër në fuqi, duke propozuar miratimin e saj.

Ka pyetje? Nuk ka.

Nuk ka pyetje, sepse të gjithë duan të jenë më të sigurt në aviacionin civil.

A ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord në parim? Dakord.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Dakord?

Neni 2. Dakord?

Kush është dakord në tërësi?

Miratohet në tërësi projektligji.

Faleminderit edhe për prezencën tuaj!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Dokument parlamentar

PROCESVERBAL

Datë 9.9.2014, ora 10:05

Drejton mbledhjen:

Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Fatmir Xhafaj, Bashkim Fino, Ulsi Manja, Xhemal Qefalia, Blendi Klosi, Spartak Braho, Armando Prenga, Vasilika Hysi, Pandeli Majko, Piro Lutaj, Armando Subashi, Petrit Vasili, Vexhi Muçmataj, Nard Ndoka, Mark Frroku, Tom Doshi, Silva Caka

Mungojnë:

Dashamir Peza, Oerd Bylykbashi, Edi Paloka, Gent Strazimiri, Arben Ristani, Keltis Kruja, Gjovalin Bzheta, Kastriot Islami, Tahir Muhedini, Fatmir Mediu, Eduard Halimi dhe Mhill Fufi.

Të ftuar:

Sajmir Tahiri – ministër i Brendshëm.

Pranvera Behushi – drejtoreshë Juridike në Ministrinë e Brendshme.

Alma Mele – përfaqësuese e Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët

Renata Palluci – specialiste e Drejtorisë Juridike në Ministrinë e Brendshme

Fatmir Xhafaj – Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, shqyrtimin e projektligjit “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

Të pranishëm janë ministri i Brendshëm, zoti Sajmir Tahiri, së bashku me ekipin e ministrisë, me të cilin do të trajtohet projektligji në vazhdimësi: zonja Behushi, drejtoreshë juridike, zonja Mele, drejtoreshë e Drejtorisë për Shtetësinë dhe Refugjatët, dhe zonja Palluci, specialiste në Drejtorinë Juridike.

Projektligji ka kohë që është depozituar në Kuvend dhe, për shkak të ngarkesës që ka pasur komisioni gjatë muajit korrik, nuk është bërë e mundur të shqyrtohet. Kështu që do të duhet të ecim pak shpejt me këtë projektligj për të kapur edhe kohën e humbur.

Fillimisht do të dëgjojmë ministrin, pastaj relatorin zotin Manja, dhe do të vazhdojmë me procedurën e zakonshme.

Zoti Ministër, ju lutem!

Sajmir Tahiri – Faleminderit, i nderuar zoti kryetar!

Të nderuar deputetë, Ministria e Punëve të Brendshme ka paraqitur në qeveri dhe qeveria më pas ka miratuar projektligjin “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, që vjen para jush për shqyrtim.

Ky projektligj vjen dhe paraqitet në këtë komision si rrjedhojë e analizimit të mangësive të kuadrit ligjor ekzistues, si dhe konstatimit të disa problematikave të veçanta, të cilat lidhen jo vetëm me procedurën e fitimit të statusit të refugjatit, por edhe me parashikimin e formave të tjera të mbrojtjes ndërkombëtare.

Gjithashtu, gjatë procesit të përafrimit të ligjit ekzistues për bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil, u konstatuan problematika të veçanta të cilat nuk mund të gjenin trajtim ose trajtesë të plotë të ndara nga ligji “Për azilin”.

Një element tjetër i rëndësishëm që konsiderohet si pjesë e zanafillës për hartimin e këtij projektligji është detyrimi i Republikës së Shqipërisë për të përafuar kuadrin ligjor me legjislacionin e Bashkimit European.

Projektligji “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” përmbledh në mënyrë të harmonizuar dy ligje ekzistuese në fushën e azilit, ligjin “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin “Për integrimin dhe bashkimin familjar të personave që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”, duke konsoliduar kështu rregullat në fushën e azilit dhe mbrojtjes ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë.

Risitë kryesore të këtij projektligji. Përveç përafrimit me legjislacionin e Bashkimit European, në konsultim të vazhdueshëm edhe me partnerët ndërkombëtarë, përveçse integron

dy projektligjet që përmenda më sipër, fut edhe një sërë nocionesh të reja, të cilat i shërbejnë më mirë mbrojtjes ndërkombëtare për personat që vijnë në Republikën e Shqipërisë.

Duke konsideruar edhe tendencën në rritje për të huajt që vijnë në Shqipëri, qoftë për azil, qoftë për të fituar statusin e refugjatit, kemi menduar që ky projektligj plotëson më së miri nevojat për të garantuar mbrojtje të plotë ndërkombëtare për këta shtetas.

Projektligji ngre Komisionin Kombëtar për Azilin dhe Refugjatët, i cili do të shërbejë si autoriteti i vetëm kompetent vendimmarrës për ankimimet kundër vendimeve të autoritetit përgjegjës për azilkërkuesit dhe refugjatët. Projektligji parashikon gjithashtu statusin e mbrojtjes plotësuese, i cili është pothuajse i barabartë me atë të refugjatit. Nga ana tjetër, projektligji zgjeron trajtimin e mbrojtjes së përkohshme, duke përcaktuar afatin e kësaj mbrojtjeje, rrethanat për refuzimin, përfundimin dhe kufizimin e saj në kushte të caktuara.

Projektligji përcakton edhe rrethanat ose kriteret, përjashtimin e personit në mbrojtje të përkohshme nga ushtrimi i së drejtës së azilkërkuesit gjatë kohës kur ky ka aplikuar për azil.

Gjithashtu, projektligji parashikon detyrimin për regjistrim në regjistrin kombëtar të gjendjes civile dhe regjistrin e administruar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, azilkërkuesve, refugjatëve dhe personave në mbrojtje.

Projektligji parashikon përjashtimin nga parimi ndërkombëtar i moskthimit në rastet kur konsiderohet rrezik për sigurinë e Republikës së Shqipërisë ose kur personi është dënuar me një vendim të formës së prerë për veprat penale, minimumi i dënimit për të cilat është 7 vjet.

Gjithashtu, për të garantuar siguri dhe regjim të ngurtë për personat që përfitojnë status, projektligji parashikon kufizimin e lirisë së lëvizjes së azilkërkuesit në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu trajton në mënyrë të detajuar praktikën dokumentare dhe procedurën që çon Republika e Shqipërisë për azilkërkuesit, refugjatët dhe personat në mbrojtje.

Në projektligj janë futur për herë të parë nocione të reja, si: vendi i tretë i sigurt, azilkërkues i mitur, i pashoqëruar e kështu me radhë.

Praktika tashmë e konsoliduar ndërkombëtare për refuzimin e azilit si pasojë e ardhjes së shtetasit nga një vendi i tretë i sigurt, duke përfshirë edhe trajtimin e veçantë të azilkërkuesve të mitur, të pashoqëruar dhe zbatimin e parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Këto pak a shumë janë aspektet kryesore të ligjit të ri për azilin në Republikën e Shqipërisë. Gjithsesi, Ministria e Punëve të Brendshme mbetet e hapur ta përmirësojë këtë ligj edhe me kontributin tuaj, për ta bërë atë të jetë në standarde edhe më të larta.

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Ministër!

Zoti Manja, keni fjalën si relator i projektligjit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Projektligji “Për azilin në Republikën e Shqipërisë” është një projektligj i rëndësishëm, i cili në thelbin e tij tregon respektin dhe humanizmin e shoqërisë dhe shtetit shqiptar për njeriun, dinjitetin njerëzor të drejtat dhe liritë themelore të tij ndaj çdo forme të diskriminimit.

Përcaktimi me këtë ligj i rregullave për dhënien e statusit të azilantit dhe trajtimin e tyre dhe të refugjatëve, s’bën gjë tjetër veçse përafron legjislacionin shqiptar me standardet më të mira evropiane dhe ndërkombëtare në këtë drejtim. Komisioni i Ligjeve në këtë projektligj është caktuar si komision për dhënie mendimi dhe në këtë kuadër detyra e tij është të shqyrtojë dhe të vlerësojë dispozitat e këtij projektligji në raport me Kushtetutën e RSH-së. Në këtë kontekst, për sa i përket analizës së projektligjit nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore, projektligji i paraqitur është bazuar në Kushtetutën e RSH-së, neni 81, pika 1 e saj, si dhe është në pajtim me Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, duke plotësuar kriteret ligjore që kërkohen për propozimin e një projektligji.

Në dokumentacionin e paraqitur, projektligji shoqërohet nga relacioni përkatës, sipas kërkesës së nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Në lidhje me rëndësinë, qëllimin, përmbajtjen dhe risitë e projektligjit, unë s’dua të ndalem më gjatë, sepse ato u përmendën në komision nga propozuesit e projektligjit, por në cilësinë e relatorit të këtij projektligji mendoj se disa çështje mund të kenë nevojë të diskutohen në mënyrë që të dalin më qartë kompetencat dhe mënyra e organizimit të autoriteteve përgjegjëse.

Në projektligj përcaktohet se autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët është struktura përgjegjëse në ministrinë përkatëse për çështjet e azilit dhe refugjatët. Sa është numri i personelit të kësaj strukture? Cili është raporti mes strukturës përgjegjëse në ministrinë përkatëse dhe Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit? Projektligji parashikon se azilkërkuesi duhet ta plotësojë aplikimin për azil sa më shpejt që të jetë e mundur. Ku duhet ta bëjë aplikimin azilkërkuesi? Mos duhet të detajohet më mirë vendi dhe mënyra e kryerjes së këtij aplikimi? Kush është autoriteti përgjegjës që i trajton

azilkërkuesit gjatë qëndrimit në territorin e RSH-së? Në rastet e ndalimeve të personave, a duhet të parashikohet me ligj procedura që nga momenti i ndalimit të azilkërkuesve në kufi ose jo, deri në akomodimin e tyre në qendrat pritëse?

Së fundi, si relator, e vlerësoj rëndësinë miratimit të këtij projektligji, pasi me këto ndryshime bëhet i mundur rregullimi i fushës së të drejtave dhe rregullimeve për azilkërkuesit, refugjatët dhe personave me mbrojtje nga autoritetet përgjegjëse në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, unë dhe kolegët e mi rezervojmë të drejtën për të ndërhyrë, për të bërë plotësime dhe amendime në lidhje me ato që parashtrova, të cilat në përfundim të shqyrtimit nen për nen, së bashku me ndryshimet, komentet dhe reflektimet, do të bëhen pjesë e këtij projektligji dhe do t'ia përcjellim komisionit përgjegjës dhe më pas, seancës plenare të Kuvendit të Shqipërisë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Manja!

Kush ka pyetje?

Zoti Fino, keni fjalën!

Bashkim Fino - Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam dy çështje, duke marrë shkas nga relatori.

E para, kemi pasur dy ligje për azilin, një i miratuar në vitin 1998 dhe tjetri në vitin 2003. Vijnë sot me një projektligj të ri. Shumë mirë.

Kjo ka të bëjë me përafrimin me direktivat, apo sjell ndonjë risi më të veçantë?

Ky është një projektligj shumë i rëndësishëm. A janë marrë në konsideratë mendimet e organizmave ndërkombëtare, si UNCR-ja apo institucione të tjera, të cilat gjatë gjithë kësaj kohe na kanë ndihmuar shumë për këto probleme.

E dyta, nuk më rakordon relacioni me projektligjin, sepse nga relacioni del që nuk ka efekte financiare për vitin 2014. Në rregull, e quaj të mirëqenë këtë që thuhet këtu, por s'e kuptoj detajimin e shpenzimeve dhe planin e ndryshimit prej seksioneve të Qendrës Kombëtare Pritëse Azilkërkuese në Babru, e cila është detajuar me fonde page, me shpenzime page, me shpenzime për mallra e shërbime e kështu me radhë.

Absolutisht që projektligji duhet të ketë një fond të caktuar, por kjo është pjesë e buxhetit të shtetit dhe unë nuk e di nëse ju e keni në fondin e ministrisë për vitin 2014 dhe natyrisht, që kjo është në funksion të ligjit të ri që po miratojmë. Do të bëhet e mundur që në buxhetin e shtetit të vitit 2015 ta keni më të detajuar dhe të kemi një fond, që të mos mbetemi jashtë vëmendjes. Dua një sqarim për të kuptuar këtë detajim që bëni tani e bëni për

3-4 muaj apo e keni pasur në buxhet, apo do të rikërkoni në buxhetin e 2015, sepse janë gjëra që edhe publiku duhet t'i dijë. Këto të dyja kam. Faleminderit!

Fatmir Xhafaj – Faleminderit, zoti Fino!

Ju lutem, për përgjigje, zoti Ministër!

Sajmir Tahiri – Faleminderit! Nëse mundem, zoti kryetar, të përfshij në përgjigjen time dhe një koment të shkurtër për sa tha relatori.

Fatmir Xhafaj – Po, absolutisht po.

Sajmir Tahiri – Bie pothuajse dakord për gjithçka u tha nga relatori vetëm me një saktësim. Projektligji nuk synon të qartësojë deri në detaje çështje të cilat mund dhe të trajtohen nga aktet nënligjore në zbatim të ligjit. E para. Pra të gjitha çështjet që ju ngritët: vendi, koha e marrjes dhe kështu me radhë.

E dyta, janë dy ligje ekzistuese, të cilat nuk kanë në fokus këtë çështje, por që në dispozitat e tyre kanë përcaktime rregullatore për çështjen e refugjatëve dhe të azilkërkuesve, që është ligji “Për të huajt”, si dhe ai “Për kufirin dhe migracionin”. Në këto dispozita përcaktohet se cilat janë detyrat e autoriteteve kufitare në momentin kur paraqiten shtetas të tillë, cilët janë ata që në filtrat përkatës klasifikohen si të tillë dhe pastaj drejtohen nga institucionet e tjera vazhduese e kështu me radhë. Pra, duhet të shikohet në harmoni me kuadrin ligjor ekzistues, përfshirë edhe ligjin që kemi sjellë për ndryshim.

Për sa i takon pyetjes, ligji, përveç përafrimit me standardet më të larta të legjislacionit të BE-së, sjell edhe risitë që përmenda në parashtresën fillestare, për sa u përket statusit, trajtimit, mbrojtjes së veçantë, përjashtimit nga parimi i moskthimit, gjëra të cilat në një mënyrë të paplotë ishin parashikuar në legjislacionin ekzistues, por kishin nevojë për t'u përshtatur me legjislacionin europian nga njëra anë dhe nga ana tjetër për t'u konsideruar parime që gjenin implementimin e plotë në ligjin tonë.

E dyta, projektligji është konsultuar vazhdimisht që në fazën e hartimit me një sërë institucionesh vendase dhe të huaja, të cilat në vazhdimësi asistojnë institucione shqiptare jo vetëm në fazën e hartimit të ligjeve, por edhe në trajtesat konkrete të çështjes së azilantëve dhe të refugjatëve. Në rastin konkret, ju keni përpara një shkresë të UNHCR-së. Ne për më shumë se 6 muaj kemi pritur përgjigje nga ky institucion. Kemi një korrespondencë të detajuar për të kërkuar përgjigje lidhur me projektligjin, përgjigje që nuk ka ardhur. Jemi ende në fazën që përpara këtij komisioni të shtrohen edhe sugjerimet e UNHCR-së dhe ne jemi të gatshëm t'i marrim parasysh për të përmirësuar aspekte të veçanta të ligjit. E theksoj se për më shumë se 6 muaj kemi pritur përgjigje, por ajo nuk ka ardhur kurrë. Nuk mund të

prisnim më gjatë, pavarësisht se eksperiencia, ekspertiza dhe profesionalizmi i ekspertëve të UNHCR-së ishte i nevojshëm për ekspertët tanë.

Faleminderit!

Fatmir Xhafaj - Faleminderit, zoti Ministër!

Ka pyetje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Sajmir Tahiri - Është një aspekt i rëndësishëm. Dispozitat e ligjit nuk janë në kundërshtim me relacionin. Në ligj rregullohet gjithçka që është parashikuar sot në buxhet dhe planifikohet të parashikohet në vitin 2014. Nuk ka efekte financiare shtesë. Jemi konsultuar me Ministrinë e Financave dhe është detajuar me aq sa mundet efekti financiar, i cili nuk është shtesë, por është parashikuar në buxhet, duke parashikuar kuotën ditore për personat që priten në strukturat, qendrat përkatëse për refugjatët dhe azilkërkuesit. Gjithçka është sipas parashikimeve buxhetore të miratuara nga ky Kuvend.

Fatmir Xhafaj – Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Frroku.

Mark Frroku – Nëse azilkërkuesit për vitin 2014 do të jenë dy, tre apo pesëfish me këto që parashikojmë ne, çfarë do të bëhet me buxhetin? Tendenca për azilkërkuesit është në rritje. Absolutisht që po. Ka një fond total, i cili është i planifikuar.

Sajmir Tahiri - Ka një fond shtesë dhe buxhet të veçantë, por në situata të pazakonta kjo del përtej përcaktimeve buxhetore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke përfshirë edhe Këshillin e Ministrave dhe sigurisht parlamentin.

Fatmir Xhafaj - Besoj se nuk ka pyetje të tjera. Ka diskutime? Nuk ka.

Kush është dakord me votimin në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Jam dakord me ato që parashitroi edhe vetë ministri dhe relatori se është një projektligj tejet i rëndësishëm për shkak të fushës që rregullon, sensibilitetit që ka dhe vëmendjes që kanë institucionet ndërkombëtare.

Në shqyrtimin nën për nën kërkohet një impenjim i veçantë nga relatori dhe nga kolegët, duke mbajtur në konsideratë faktin që më në fund ka disa sugjerime të UNHCR-së. Nga ana e relatorit, por edhe nga kolegët ka nevojë për ta parë më me vëmendje.

Do të dëshiroja ta ndërpresim këtu mbledhjen dhe t'u japim mundësi përfaqësuesve të ministrisë të diskutojnë me këshilltarët dhe relatorin për detajet e problemet që janë ngritur, për t'i lehtësuar barrën debatit dhe për të qenë më eficientë gjatë diskutimit nën për nën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka të drejtë zoti Braho.

Të biem dakord paraprakisht që të lehtësojmë komisionin dhe të ecim më tej.

Po të kemi mundësi, edhe nesër po të na thuhet, ne jemi dakord që të vazhdojmë nën për nen.

Në rendin e ditës për nesër në orën 10:00 kemi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjë-Hercegovinës “Për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar”, si edhe projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Ju faleminderit!

Punë të mbarë!

Mbyllet mbledhja.